

Elona Krasniqi, PhD, është Asistente Profesore në Fakultetin e Psikologjisë në Kolegjin UBT, ku ligjeron lëndë në fushat e psikologjisë mjekësore, metodave kërkimore, psikopatologjisë, vlerësimin akut dhe menaxhimit të çrregullimeve sjellore, psikologjisë shëndetësore dhe psikologjisë së personalitetit. Ajo kontribuon në zhvillimin e kurrikulës, promovimin e kulturës kërkimore dhe mentorimin e studentëve të nivelit bachelor dhe master në praktikat profesionale dhe punimet e diplomës.

Dr.Krasniqi ,ka përvojë ndërkombëtare të gjerë kërkimore në universitete prestigjioze evropiane dhe amerikane, përfshirë University of East Anglia (UK), University of Kentucky (USA) dhe Reichman University (Israel), ku ka marrë pjesë në projekte shkencore, mbledhje të të dhënave, analiza cilësore dhe ku ka mbajtur edhe ligjërata të ftuara. Ajo është fituese e bursës prestigjioze Masaryk Distinguished Researcher, si dhe autore e disa publikimeve në revista shkencore ndërkombëtare në fushën e psikologjisë zhvillimore, shëndetit mendor të të rinjve dhe faktorëve të rrezikut dhe reziliencës.

Aktualisht, ajo është anëtare e COST Action CA23153 ,Digital Mental Health for Young People, ku kontribuon në disa grupe punuese që fokusohen në vlerësimin e hershëm, dizajnin dhe implementimin e ndërhyrjeve të shëndetit mendor dixhital për të rinj. Gjithashtu, ajo është bashkëpunëtare kërkimore në projekte të financuara nga BE, të tilla si RECONNECTED dhe PROSPERH, të cilat fokusohen në mirëqenien komunitare dhe shëndetin mendor në ambientet e punës.

Interesat e saj kërkimore përqendrohen në tranzicionin pubertal dhe ndikimin e tij në zhvillimin emocional e sjellor të adoleshentëve, rolin e prindërimit në shfaqjen e simptomave internalizuese, si dhe faktorët e rrezikut dhe reziliencës në shëndetin mendor të të rinjve. Ajo kontribuon gjithashtu si recensente shkencore për revista ndërkombëtare dhe është anëtare e shoqatave të rëndësishme profesionale në fushën e psikologjisë zhvillimore dhe kërkimit mbi adoleshencën.